

Gjykata Supreme e Republikës së Maqedonisë së Veriut, në Seancën e përgjithshme të mbajtur më 11.07.2023, duke shqyrtuar mbi iniciativën e parashtruar nga avokati Nikollço Atanasovski nga Delçeva, e evidentuar nën Su-03.nr.169/23 të datës 24.02.2023, në bazë të nenit 101 nga Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe nenit 37 paragrafi (1) pika 1 të Ligjit për gjykatat ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 58/2006...96/2019), miratoi këtë:

MENDIM JURIDIK PARIMOR

Shfrytëzimi i ditëve të lira për shkak të punës më shumë se orari i punës paraqet mungesë nga puna.

A r s y e t i m

Gjykata Supreme e Republikës së Maqedonisë së Veriut, si gjykatë më e lartë që siguron barazinë në zbatimin e ligjeve nga gjykatat, në Seancën e përgjithshme përcaktoi domosdoshmërinë për miratimin e mendimit juridik parimor mbi çështjen se vallë ditët e shfrytëzuara të lira / orët e lira për orët e punuara më parë, ndërsa orët e papaguara jashtë orarit (të cilat shfrytëzohen në bazë të ligjit dhe marrëveshjes kolektive), paraqesin mungesë nga puna në kuptim të mungesave të përcaktuara të më shumë se 21 ditë në bazë të nenit 117 paragrafi (4) të Ligjit për marrëdhënie pune, çështje kjo që nënkupton sigurimin në zbatimin unik të ligjit të cituar, nga gjykatat.

Sipas nenit 1 të Ligjit për marrëdhënie pune ("Gazeta Zyrtare e RM" nr. 62/2005, 25/13), (2) Marrëdhënia e punës rregullohet me këtë dhe me ligj tjetër, marrëveshjen kolektive dhe marrëdhënien për punësim. Sipas nenit 3 të ligjit, në marrëdhëniet e punës secila palë obligohet t'i plotësojë të drejtat, obligimet dhe përgjegjësisë e përcaktuara dhe të kontraktuara.

Sipas nenit 12 nga i njëjti ligj, (1) Gjatë lidhjes dhe shfuqizimit të marrëveshjes për punësim dhe gjatë kohëzgjatjes së marrëdhënies së punës, punëdhënësi dhe punëtori obligohen t'i respektojnë dispozitat e këtij ligji dhe ligjeve të tjera, marrëveshjet ndërkombëtare që e obligojnë Republikën e Maqedonisë dhe dispozitat tjera, marrëveshjet kolektive dhe aktet e punëdhënësit.

(2) Me marrëveshjen e punësimit, përkatësisht marrëveshjen kolektive nuk mund të përcaktohen të drejta më të vogla nga të drejtat e përcaktuara me ligj, e nëse përmbajnë dispozita të këtilla, konsiderohen të pavlefshme dhe zbatohen dispozitat përkatëse të ligjit.

(4) Të drejtat e marrëdhënies së punës të përcaktuara me Kushtetutë, ligj dhe marrëveshje kolektive, nuk mund të merren ose kufizohen me aktet dhe veprimet e punëdhënësit.

Sipas nenit 112 paragrafi (1) dhe (2) të Ligjit për marrëdhënie pune (1) Punëtori ka të drejtë për kompensim të rrogës për tërë kohën e mungesës në rastet dhe kohëzgjatje të përcaktuara me ligj, si dhe në rastet kur nuk punon për shkaqet e punëdhënësit. (2) Punëdhënësi obligohet t'i paguajë kompensim të rrogës në rastet e mungesës nga puna për shkak të shfrytëzimit të pushimit vjetor, pushimit të dhunshëm, arsimimit plotësues, festave të përcaktuara me ligj dhe ditëve të lira të punës dhe në rastet kur punëtori nuk punon për shkaqe të punëdhënësit.

Sipas nenit 117 paragrafi (1) të Ligjit për marrëdhënie pune, punëtori obligohet me kërkesën e punëdhënësit të kryejë punë jashtë orarit të plotë të punës (puna jashtë orarit) edhe atë në rast të zmadhimit ekskluziv të vëllimit të punës, nëse nevojitet zmadhimi i procesit të punës ose të prodhimit, nëse nevojitet të garantohet siguria e njerëzve dhe pronës dhe siguria e qarkullimit, dhe në raste tjera të përcaktuara me ligj apo me marrëveshje kolektive. Në paragrafin (2) të këtij neni, theksohet se puna jashtë orarit mund të zgjasë më së shumti 8 orë gjatë një jave dhe më së shumti 190 orë në vit, përveç për punët të cilat për shkak të procesit specifik të punës nuk mund të ndërpriten ose për të cilat nuk ka kushte dhe mundësi të organizohet puna në ndërresa. Në paragrafin (3) të këtij neni, theksohet se për punëtorët e Ministrisë së Punëve të Brendshme që kryejnë obligime të veçanta dhe autorizime sipas ligjit të posaçëm, puna jashtë orarit mund të zgjasë më së shumti 190 orë në vit për shkak të kryerjes së punëve të menjëhershme dhe urgjente, pasi që ka dhënë pëlqim me shkrim punëtori.

Sipas nenit 117 paragrafit (4) të LMP, punëtorit që ka punuar mbi 150 orë më shumë se orari i plotë i punës, e nuk ka munguar nga puna më shumë se 21 ditë gjatë një vitit, te punëdhënësi i njëjtë, ku nuk llogariten ditët e shfrytëzuara të pushimit vjetor, punëdhënësi obligohet që t'i paguajë përveç shtesës në rrogë edhe rrogë shtesë në lartësinë e një rroge mesatare në Republikë.

Duke u nisur nga përmbajtja e dispozitave të theksuara të LMP, në lidhje me të drejtën e punëtorit për rrogë shtesë për punën më shumë nga orari i plotë i punës, shfrytëzimi i ditëve të lira të punës më shumë nga orari i plotë i punës pa diskutim buron se paraqet mungesë të arsyetuar nga puna. Kjo sidomos buron nga neni 112 të LMP. Duke qenë se nga gjykatat veprohet ndryshe gjatë zbatimit të LMP, kurse në lidhje me çështjen e pagesës së rrogës shtesë për punën më shumë se orari i plotë i punës Seanca e përgjithshme e Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut, vijonte që të vendoset si në kumtimin e mendimit juridik parimor.

Gjykata Supreme e
Republikës së Maqedonisë së Veriut
Seanca e përgjithshme